



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 13, datë 30.06.2020

PËR

**“DHËNIEN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL SHOQËRISË “POSTA SHQIPTARE” SH.A,
PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Tomi	Frasheri	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
4. Znj. Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 30.06.2020, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Për “Dhënie e Autorizimit Individual shoqërisë Posta Shqiptare sh.a për ofrimin e Shërbimit Universal Postar”.***

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1, e nenit 7, pikat 1 dhe 6 të nenit 9, dhe pika 3 e nenit 64 të Ligjit Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (***ligji nr. 46/2015***);
2. Pika 3 e nenit 114, të Ligjit Nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (***ligji nr. 9918/2008***);
3. Ligji nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH” (***ligji nr.44/2015***);

4. Neni 7 i VKM nr. 239 datë 02.05.2018 për “Miratimin e Rregullave për përcaktimin e Ofruesit të Shërbimit Universal Postar”;
5. Urdhëri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 469 datë 27.12.2019 “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”
6. Rregullore nr. 36 datë 29.10.2015 “Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”;
7. Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr.12, datë 16.06.2020 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar: Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor:

- Dokumenti ” Autorizim Individual shoqërisë Posta Shqiptare sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar”;
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (Projekt-vendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R E N:

1. Me VKD nr. 2581 datë 22.06.2015, Këshilli Drejtues i AKEP ka pajisur me Autorizimi Individual shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a, për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjet nga hyrja në fuqi e vendimit. Sipas këtij vendimi, afati i përfundimit të Autorizimit Individual të shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar, përfundon më 6 Korrik 2020.

Me VKD nr. 06 datë 16.04.2020, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar për këshillim publik dokumentin “Analizë e Tregut të Shërbimeve Postare dhe vlerësimit i ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal”. Në përfundim të këshillimit publik, me VKD nr.12, date 16.06.2020 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar: Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur të përcaktojë shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a. si ofruesi i vetëm që plotëson kushtet ligjore për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. AKEP në lëshimin e Autorizimit Individual për Ofruesin e Shërbimit Universal Postar, është bazuar në përcaktimet e Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores nr. 36 datë 29.10.2015 “Për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Dokumenti Autorizimi Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, vendos të drejta dhe detyrime për shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a, për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar si dhe pikën 1, të nenit 7, pikat 1 dhe 6 të nenit 9, dhe pikën 3 të nenit 64 të Ligjit Nr. 46/2015, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e Autorizimit Individual shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, për një periudhë 5 vjeçare duke filluar nga data 7 korrik 2020.
2. Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a ka detyrim të ofrojë shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të Autorizimit Individual të miratuar me këtë vendim si dhe sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të sektorit postar.
3. Ky Vendim publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Tomi Frashëri

ANËTAR
Edlira Dvorani

ANËTAR
Ketrin Topçiu

ANËTAR
Xhoana Lilaj